



KUVENDI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 11 dhe 12.2 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, në pajtim me nenin 9 të Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr.06/L-005, nenet 14 dhe 15 paragrafi 2.3 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot. 01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 23 nëntor 2020, miratoi këtë,

VENDIM PËR CAKTIMIN E NORMAVE TATIMORE PËR TATIMIN NË PRONËN E PALUAJTSHME PËR VITIN 2021

Neni 1

Normat Tatimore

1. Caktohen normat tatimore për vitin 2021 për të gjitha kategoritë e pronave në territorin e Komunës së Podujevës, me përjashtim të kategorisë pronë publike, si vijon:

1.1. Për njësitë bujqësore të parcelave.....	0.15 %
1.2. Për njësitë bujqësore të objekteve.....	0.15 %
1.3. Për njësitë pyjore të parcelave.....	0.15 %
1.4. Për njësitë rezidenciale të parcelave.....	0.15 %
1.5. Për njësitë rezidenciale të objekteve.....	0.15 %
1.6. Për njësitë komerciale të parcelave.....	0.15 %
1.7. Për njësitë komerciale të objekteve.....	0.20 %
1.8. Për njësitë industriale të parcelave.....	0.15 %
1.9. Për njësitë industriale të objekteve.....	0.20 %

2. Normat tatimore sipas këtij neni caktohen konform Ligjit nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, (neni 9 paragrafi 1, nën paragrafët 1.1 deri 1.9)

Neni 2

Zbatimi

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa - Zyra e Tatimit në Pronë.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, dhe i njëjti zbatohet nga data 01 janar 2021.

Nr.prot. 01-400/01-0071479/20
Podujevë, 23 nëntor 2020

